

KËRKESË
Nr.701/1, datë 24.2.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës së re 9-vjeçare publike, në lagjen “Besëlidhja”, Lezhë, ku subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Lezhë.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët, preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit. të llogaritur nga komisioni i posaçëm për procedurat e shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me adresë: Rruga e Durrësit, nr.23, Tiranë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj